

VENDIM
Nr. 881, datë 30.10.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “SISTEMIM ASFALTIM RRUGA SHKOZET – DURRËS (ZONA E KËNETËS)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Sistemim asfaltim rruga Shkozet – Durrës (zona e kënetës)”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë tokë “arë”, me sipërfaqe 680 (gjashtëqind e tetëdhjetë) m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 2 120 920 (dy milionë e njëqind e njëzet mijë e nëntëqind e njëzet) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 120 920 (dy milionë e njëqind e njëzet mijë e nëntëqind e njëzet) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësime”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar ZVRPP”, “Vërtetim hipotekor”, “Certifikatë pronësie”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 e 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR”
SISTEMIM-ASFALTIM RRUGA SHKOZET DURRËS, ZONA E KËNETËS”

Nr.	PRONARI	Nr. pas	ZK	Lloji				Shënime
	Emri, atësia, mbiemri				Sip (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	
	Spitallë ZK. 8517 (Durrës)							
1	Spiro Roçi	171/260	8517	are	45	3119	140355	Konfirmim ZVRPP
2	Adile Roçi	171/261	8517	are	45	3119	140355	Konfirmim ZVRPP
3	Agim Roçi	171/262	8517	are	45	3119	140355	Konfirmim ZVRPP
4	Edmod Roçi+bp	171/254	8517	are	35	3119	109165	Konfirmim ZVRPP
5	Edmond Kurti	171/255	8517	are	20	3119	62380	Konfirmim ZVRPP
6	Edi Zeria	172/128	8517	are	300	3119	935700	Konfirmim ZVRPP
7	Fondacioni “Liohana”	172/129	8517	are	190	3119	592610	Konfirmim ZVRPP
	TOTALI				680		2120920	